

VENDIM
Nr. 37/2020

PËR DEKLARIMIN E PËRFUNDIMIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË
PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT
TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË
DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deklarimin e përfundimit të veprimtarisë së Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 74/2018 “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’”, të ndryshuar.

II. Dokumentacioni administrativ i krijuar nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në përmbushje të detyrave të tij, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, i kalon dhe administrohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

III. Me përfundimin e veprimtarisë së Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përfundojnë edhe mandatet e anëtarëve të Komisionit të emëruar me vendimin nr. 97/2018 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe vendimin nr. 109/2018 “Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’”.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.